



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

I mbledhjes së nëntë të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 9.10.2024,
duke filluar në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Fehmi Kupina - kryesues i komitetit, anëtarët e komitetit: Milazim Vitija, Jeta Rafuna, Dhurata Jahaj Retkoceri, Leutrim Retkoceri, Shegë Beqiri, Arbnora Berisha, Gëzim Sveçla, Nora Kelmendi, Mirsad Vitia, Bahri Gashi.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: Izet Sadiku – drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, Valbona Makolli – drejtore e Drejtorisë së Financave dhe Premtime Preniqi, zyrtare e lartë për barazi gjinore.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Fehmi Kupina – kryesues i komitetit, me këtë:

REND DITE

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tetë të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Propozim-vendimi për vënien në diskutim publik të Projektplanit lokal të veprimit për barazi gjinore 2024-2026;
3. Statuti i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Prishtinë;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për përcaktimin e procedurave dhe formave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për më pak se një vit, sipas rekomandimeve të dhëna nga MAPL-ja;
5. Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Prishtinës për vitin 2023 dhe Planit i veprimit të menaxhmentit;
6. Propozim-vendimi për ndërrimin e destinimit të bll.I-1, Q-2, I-2, sipas destinimit të PZHU-së në Prishtinë;
7. Propozim-vendimi për ndryshimin e riparcelimit sipas gjendjes aktuale kadastrale (te banimi individual), të Planit rregullues “Prishtina e re – Zona perëndim” në Prishtinë;
8. Informatë mbi punën e Njësisë së auditimit të brendshëm për vitin 2023;
9. Informatë e punës 1 janar -31 gusht 2024, i NPL “Pallati i Rinisë”;
10. Të ndryshme.

Kryesuesi:- pasi përshëndeti të pranishmit e konfirmoi edhe kuorumin dhe vazhdoi me pikat e rendit të ditës të sipërcekura dhe njëherazi pyeti se a dëshiron dikush ta marrë fjalën rreth pikave të rendit të ditës.

Nora Kelmendi: - Kryesues, përfaqësuesi i departamentit ligjor nuk është këtu kështu që nuk po fillojmë hiç sepse kam shumë pyetje për ta.

Bahri Gashi: - kërkoi që pika për bashkësitë lokale të plotësohet dhe të futet në fillim të rendit të ditës me plotësime pasi ishte e paraparë. Tutje tha se është e kompletuar dhe kërkoi të vendoset te pika e dytë.

Nora Kelmendi: - pyeti se a mundemi pa përfaqësuesin e zyrës ligjore.

Kryesuesi: - tha se ne mundemi më e miratuar ekstraktin e procesverbalit edhe pa të dhe mundemi me vazhdu me Izetin, kështu që vazhdojmë me pikën e parë deri sa të vjen.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tetë të Komitetit për Politikë dhe Financa

Gëzim Sveçla: - tha se në mbledhjen e kaluar KPF-ja i ka pas dy rekomandime, raportimi i kryetarit edhe çështja e mësimit tërëditor, janë rekomandime që janë votuar prej këtij komiteti, kurse pyeti pse një muaj pas ato dy pika nuk janë në rendin e ditës.

Kryesuesi: - tha se në bisedë me kryetarin e kemi diskutuar me kryetarin që në muajin tjetër të raportojë.

Nora Kelmendi: - pyeti se kur do të raportojë “Prishtina Parking”, sepse kam shumë ankesa.

Kryesuesi: tha se nuk e di për “Prishtina Parking” kur do të raportojë, por në këtë mbledhje e ka “Pallati i Rinisë”. Tutje ai hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës.

Osman Bllaca: - informoi se përfaqësuesi i zyrës ligjore qenka me grip dhe s’mund të vijë.

Nora Kelmendi: shprehu shqetësimin lidhur me mungesën e zyrtarit ligjor ku tha se zyra ligjore nuk na kthen përgjigje ose na kthen përgjigje të mangët, dhe se kryetari po vazhdon qysh po ka qejf bashkë me LDK-në, kurse zyra ligjore duhet me pas zëvendësues kur sëmuret shefi.

Leutrim Retkoceri: - propozoi që nëse Nora nëse i ka nga pyetjet, tha t’i kalojmë dhe kur vjen zyra ligjore ia shtron pyetjet.

Kryesuesi konstatoi se u miratua unanimisht ekstrakti i procesverbalit i mbledhjes së shtatë të Komitetit për Politikë e Financa.

Pika e dytë

Propozim-vendimi për vënien në diskutim publik të Projektplanit lokal të veprimit për barazi gjinore 2024-2026

Kryesuesi: pasi që drejtori Izet ka një takim ne kërkojmë të kalojmë njëherë te pika e tretë.

Izet Sadiku: tha se ne e kemi një takim që domethënë kolegji i drejtorëve e ka bërë me Ministrinë Shëndetësisë gjatë regjistrimit të pacientëve më mjekët familjarë, një proces që është bërë në krejt Kosovën që është goxha i rëndësishëm për Shëndetësinë dhe nëse ka mirëkuptim ta prezantoj pikën për shkak të takimit.

Pika e tretë

Statuti i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Prishtinë

Izet Sadiku: - tha se ne e kemi propozuar një statut që është uniform, i cili është domethënë veç specifikat e Qendrës të Mjekësisë Familjare kryesore i ndryshon, i cili statut sipas ligjit duhet të aprovohet në Ministrinë e Shëndetësisë me e marr lejen, pastaj ai vjen dhe aprovohet, ne e kemi heq këtë procedurë, Ministria e ka kthyer dhe kemi propozuar-dorëzuar që me e anuluar dhe jemi në hap në pak qendra të Mjekësisë Familjare në Kosovë, statutin e ri që e ka logon e re, formën e re nuk ka ndryshime përmbajtësore, por i ka disa konceptuale. Logo e QKMF-ve është e ndryshme që duhet aprovuar në Ministri. Ky është propozimi që kemi bërë marrëveshje me QKMF-në dhe mendoj që për çdo paqartësi mundemi me dhënë sqarime.

Osman Bilaca: - pyeti drejtorin se a jeni konsultuar për njësinë e prokurimit.

Izet Sadiku: - tha se kam biseduar me zyrën ligjore dhe jemi në rregull dhe njësi prokurimi mundet me pas, njësi prokurimi kanë krejt statutet zyrtare që i dërgon Ministria se për arsye së një pjesë të procedurave i kryen Ministria. Këtu problemi është se pastaj ZKA. Drejtori pastaj dha sqarimet e nevojshme lidhur me procedurat.

Osman Bilaca: - nëse ai i ka deleguar është diçka tjetër, të ne s'ka delegim. Te ne ke marrëveshje të Ilir Tolajt, Sali Gashit me atë funksionon, nuk ishit atë ditë ju, kemi thirrur të gjithë, ne vetëm me i dhënë kahje ligjore.

Izet Sadiku: - tha Njësia e prokurimit si njësi, ekziston çdokund ose ka zyrë ose njësi prokurimi, por procedurë të prokurimit ZKA nuk ka.

Gëzim Sveçla: - kërkoi të sqarohet neni 6, pika 9, mjeku familjar duhet të jetë i certifikuar për të ofruar shërbime të ultrazërit. Tha se në statut është e vetmja fushë e caktuar që përmendet që nuk duhet me qenë pjesë e statutit, sepse statuti s' duhet të ketë një veprimtari të caktuar për shembull për ultrazërin në këtë rast, sepse pastaj duhet me qenë i certifikuar edhe stomatologu, mjeku i përgjithshëm e shumë tjerë.

Izet Sadiku: - tha se kjo formë ose arsye Gëzim një radiolog ka pas reagime pse bëhet ultrazëri nga mjeku familjar dhe është thënë se një mjek familjar mundet me pa edhe pse gjatë shkollimit specialistik ai e mëson ultrazërin, por pa e bërë një trajnim i cili i certifikohet ai nuk mund të bëjë ultrazë.

Gëzim Sveçla: - te neni 7 pika 1.4 shërbimet, kujdesi akut dhe urgjent, QKMF nuk ka shërbim urgjent.

Izet Sadiku: - tha në krejt Kosovën e ke, vetëm ne nuk e kemi, sepse me një vendim të Kuvendit të Prishtinës, që në fakt s'e dimë a ekziston më Ministri kur është bërë Kuvendi ka marrë vendim urgjenca e Prishtinës është e ndarë në përgjegjësi të veçantë nuk ka urgjencë si qendër urgjente në Kosovë vetëm Prishtina e ka.

Gëzim Sveçla: - tha se e tani të lidhet me nenin 9, pika 1.6. Sektori i kujdesit urgjent, nuk ke sektor të urgjencës.

Izet Sadiku: - domethënë është ai sektor, çdo statut në çdo komunë vetëm Komuna e Prishtinës nuk e ka më urgjencën.

Gëzim Sveçla: - tha 1.2, mandej pika 9, 1.2.5 ke thënë shërbimet teknike dhe autoparkun, të ndahet autoparku, pastaj pika 12 këshilli i pacientëve, kush është ky këshilli i pacientëve?

Izet Sadiku: - tha këshilli i pacientëve që duhet të themelohet, vetëm 5 komuna në nivel të Kosovës e kanë të themeluar, qysh e ka QKU-ja me sa di edhe Mitrovica e ka bërë, kurse me ligj të Ministrisë duhet detyrimisht të ketë këshill të pacientëve.

Gëzim Sveçla: - këtu të neni 14 emërimi i drejtorit pika 2.1. e ke bërë të jetë mjek specialist nga mjekësia familjare, është një penalizim për të tjerët, pse duhet më qen nga mjekësia familjare, mundet me qenë mjek specialist i specializuar në një fushë të caktuar.

Izet Sadiku: - Përveç radiologut dhe biokimistit specialistët tjerë nuk kanë drejtë me qenë drejtor në QKMF.

Gëzim Sveçla: - çfarë e ndalon një radiolog me qenë drejtor i QKMF-së se është penalizim kjo.

Izet Sadiku: - tha se 95 % të stafit i ke mjekë familjarë.

Gëzim Sveçla: - tha ata 5 % pse po i penalizon? E ke të 1.3 të sqaruar mirë komisionin e ankesave të 1.3 neni 17. Dyshkallshmëria a ka brenda institucionit, a është e larguar prej institucionit për shkak së kjo mandej paraqet konflikt interesi nëse dyshkallshmëria është brenda institucionit se duhet me u ankuar diku tjetër jashtë institucionit. Shkalla e parë duhet me qenë institucion, shkalla e dytë nuk duhet me qenë institucion, këtë duhet me e shikuar në aspekt ligjor.

Osman Billaca: - propozoi që thirrjet që nuk janë urgjente të bëhen me pagesë (rastet me tension, sheqer, vizitë, etj).

Gëzim Sveçla: - nuk u pajtua me propozimin e Osmanit, pastaj shtoi se te neni 26 të pika 2 buxheti dhe llogaritë e QKMF-së përfshin tërë shpenzimet operative të njërive punuese QKMF-ja a ka llogari bankare? Së e ke përmend buxhetin e QKMF-së a në anën tjetër QKMF-ja s'ka llogari a po kupton.

Izet Sadiku: - tha gjithë shpenzimet operative përfshihen përmes Ministrisë së Shëndetësisë, komunat asnjë nuk bëjnë pagesa.

Izet Sadiku: - dha sqarime për procedurat e prokurimit.

Gëzim Sveçla: - tha se çështjen e mjekut familjar e ke llogarit të raporti i punës të premtimet e realizuara. Ky është projekt i Ministrisë së Shëndetësisë, mjeku familjar, Prishtina ka qenë pilotprojekt kur është bërë tash është bërë në gjithë Kosovën, GAPI të ka llogarit mjekun familjar që e ka përfunduar Drejtorja e Shëndetësisë, nuk e ka kryer Drejtorja e Shëndetësisë, është projekt i Ministrisë së Shëndetësisë.

Izet Sadiku: - tha se premtim i Përparimit kanë qenë që të bëhet zonimi në Prishtinë, është bë edhe ata kanë kërkuar këto premtime që ka thënë Përparimi zoonimin, mjekun familjar, kurse ne i kemi bë dy pilotime që i ka bë Ministria bashkë me neve po në asnjërin s'kemi rezultate sa është punuar. Premtimi i tij ka qenë të bëhet zoonimi kur ndahet, sot në Prishtinë e ka pranuar edhe Ministria, Prishtina është i vetmi qytet që i ka zonat e ndara.

Osman Billaca: - tha Izet vetëm në statut po shënon llogaria e QKMF-së, propozoi të hiqet neni 22.

Pika e dytë

Propozim-vendimi për vënien në diskutim publik të Projektplanit lokal të veprimit për barazi gjinore 2024-2026

Premtime Preniqi: - dha sqarime sesi plani ka filluar me iniciativën e zyrtarëve, mandej n një vendim nga kryetari ku janë caktuar anëtarët lidhur me hartimin e planit, duke i cekur objektivat strategjike siç janë: promovimi i barazisë gjyqësore, fuqizimi i grave dhe vajzave, fuqizimi

ekonomik dhe promovimi i të drejtave ekonomike, sociale të punësimit, etj. Gjithashtu ajo foli edhe për bashkëpunëtorët dhe anën ligjore nga është bazuar plani.

Bahri Gashi: - tha se a kemi ndonjë pasqyrë të gjendjes se çfarë ndodh realisht në Prishtinë, duke shtuar se ka dëgjuar për shifër të lartë të dhunës në familje dhe se numër i vogël i rasteve lajmërohet në institucione, pastaj pyeti për gjendjen reale në Komunën e Prishtinës.

Premtime Preniqi: - tha se shifrat që keni cekur nuk janë reale, duke cekur se mbajnë takime çdo 3 muaj dhe marrin informacione të sakta në çdo muaj nga Qendra për Punë Social, Policia dhe Strehimorja.

Bahri Gashi: - pyeti se a ka Prishtina strehimore

Premtime Preniqi: - Po ka dhe është shumë aktive ka objektin edhe financohet.

Bahri Gashi: - tha se është një strehimore në Prishtinë që realisht me sa e di unë ka qenë pa mbikëqyrje zyrtare, po ka mbikëqyrje shoqërore ose kolegjiale, nëse ata e kanë marr barrën për me financuar një pjesë të programit, ne duhet me e ditë si funksionon ajo, është mirë apo ka probleme ajo shtëpi brenda.

Premtime Preniqi: - tha se ajo është pjesë e grupit, pjesë e këtij mekanizmi koordinues kundër dhunës në familje.

Pika e katërt

Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për përcaktimin e procedurave dhe formave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për më pak se një vit, sipas rekomandimeve të dhëna nga MAPL-ja.

Kryesuesi: - tha se kam kërkuar nga zyra ligjore për largimin apo moslargimin e pikave të rendit të ditës në mbledhjen e KPF-së.

Pas shumë diskutimeve nga ana e anëtarëve të KPF-së, u vendos që të largohet nga rendi i ditës pika e 4. **Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për përcaktimin e procedurave dhe formave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për më pak se një vit, sipas rekomandimeve të dhëna nga MAPL-ja.**

Pika e pestë

Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Prishtinës për vitin 2023 dhe Plani i veprimit të menaxhmentit

Gëzim Sveçla: - tha se Raportin e Auditimit paska me prezantuar Osmani, ky është raport i auditimit të jashtëm shtetëror, kurse Osmani është auditor i brendshëm, a ka konflikt interesi këtu.

Kryesuesi: - kërkoi nga zyra ligjore në rastet kur drejtorët mungojnë për ta elaboruar pikën e rendit të ditës në KPF, ajo pikë a duhet të largohet nga rendi i ditës apo jo.

Fatos Dibra: - tha se unë e kam thënë shumë shpesh në mbledhje të KPF-së, KPF-ja i shqyrton pikat, jep rekomandime, voton rekomandime, po nuk vendos për pikat e rendit të ditës se është kompetenca e dikujt tjetër. Pikën e rendit të ditës nëse në KPF nuk ka kanë drejtori, në mbledhje të Kuvendit vendoset rekomandimi i KPF-së për m'u heq rendi i ditës edhe ashtu si proces domethënë është thënë më herët ne themi që është çështje e votave në Kuvend.

Kryesuesi: - tha se unë po i referohem komitetit, nëse drejtorët mungojnë si duhet të veprojnë ne me pikat e tyre që janë në rend të ditës.

Fatos Dibra: - tha edhe kur kam thënë që nuk vendos KPF-ja për pika, ka ndodh që ka vendos, ti i ke heq si KPF po flas. Sa i përket aspektit ligjor, juridik unë prapë mendoj që KPF-ja nuk e ka kompetencën me i heq pikat e rendit të ditës, për çështjen e mungesës së drejtorëve nuk di çfarë të them, përndryshe në aspektin ligjor mendoj që KPF-ja nuk e ka kompetencë heqjen e pikave të rendit të ditës.

Nora Kelmendi: - tha se nëse ne nuk jemi kompetentë për heqjen e pikave, kush na sqaron lidhur p.sh me pikën e përgatitur nga Doruntina.

Kryesuesi: - tha se po e marr përsipër që herëve tjera t'i ftoj personalisht drejtorët që të vijnë dhe të prezantojnë pikën e rendit të ditës, përndryshe ajo pikë largohet nga rendi i ditës.

Gëzim Sveçla: - tha se raporti është i auditimit të jashtëm, kurse po e prezanton auditori i brendshëm, në këtë rast pyeti se a ka konflikt interesi.

Fatos Dibra: - kërkoi kohë që të përgjigjet në pyetjen e parashtruar.

Gëzim Sveçla: - kërkoi të marrë përgjigje para seancës së Kuvendit, duke shtuar që Kryetari duhet ta prezantojë sepse raporti i auditimit ka të bëjë mbi krejt organizmat që i ka komuna, pasi që edhe në fund krejt përgjegjësitë, meritat, dëmin, të gjitha i merr Kryetari.

Valbona Makolli: - tha se në mungesë të kohës, kryetari i autorizon një ose dy persona të cilët janë bartës të tyre, së pari i përgjigjen auditorit dhe i përgjigjen Kryetarit direkt për rekomandime, përmirësime, sikurse raportet financiare, kemi shkuar me praktikë të njëjtë.

Osman Billaca: - tha pas ardhjes së raportit ne e kemi bërë planin e veprimit bashkërisht me Valbonën, dhe personat që janë përgjegjës dhe në fund ia përcjellim Kryetarit i cili e ka nënshkruar. Për 22 të gjetura e kemi bërë planin e veprimit dhe secili person përgjegjës në afat kohor me veprimet të cilat ka me i ndërmarrë menaxhmenti në lidhje me atë rekomandim, deri më sot tash p.sh detyrimet kontingjente është përgjegjësi e zyrës ligjore edhe kanë ndërmarr hapa deri tash, e ka caktu personin përgjegjës Rina Govorin, ajo ka fillu me një databazë me mbledhjen e krejt detyrimeve që janë paditë edhe çka bëhet në gjyqe edhe tash për me qenë sa më të sakta.

Bahri Gashi: - tha në një takim kur kemi qenë me Leutrimin, ky e ka lyp një problem që është permanent që dy, tre muaj apo më shumë, pyeti se a ka shkelje permanente të auditimit për çdo ligj që ka ndodh.

Osman Billaca: - tha po ka, problemin më të madh Komuna e ka ekzekutivin e ulët të buxhetit në investime kapitale, e ke suficitin e lartë, i cili bartet prej dhjetëshit, njëzet e dyshit, njëzet një, tash këtu është një problem shumë i madh këtu ne kemi shkuar duke e zgjidh p.sh është rritë shpenzimi kapital prej tridhjetë e diçka milionë është bërë në katërdhjetë e diçka.

Gëzim Sveçla: - tha se nuk mundesh me thënë që je duke e zgjedh kur është rritë suficiti e ke pas katërdhjetë e pesë milionë tash të janë bërë pesëdhjetë.

Osman Billaca: - ekzekutimi sa më i lartë, e ke pas ekzekutimin e ulët tash kur të rritsh ekzekutimin, rritet vlera e të hyrave, p.sh është një përmirësim i ulët ka qenë i ulët, por ky problem është i kamotshëm edhe është shumë i madh, nuk mundet me u zgjedh për një vit, dy vite, tri vite nuk është i pazgjidhshëm, p.sh tani ke probleme me pronat të cilat janë të Fushë Kosovës ato janë prej dy vitit 2014, janë probleme që vazhdimisht bëhen.

Kryesuesi- pyeti se a mund ta prezantojë Osmani raportin e auditorit.

Gëzim Sveçla: - konfirmoi se mund ta prezantojë.

Osman Billaca: - tha se opinioni për pasqyrat financiare për vitin 2023 është negativ, dhe janë katër elemente të cilat e kanë shtyer në bazë të materialitetit i cili ka ardh në përfundim auditori i jashtëm për pasqyrat financiare 2023 të cilat i ka pasqyruar edhe konstatuar që janë të kualifikuara për arsye sepse ... Është opinion negativ edhe krejt këto janë elemente dhe detyrime kontingjente që janë nënvlerësuar për një milionë e katërqind e njëzet e nëntë mijë, këto mundet edhe Fatosi me na i shpjegu, kur te vijne komplet më së pari kur te paditë komunën, paditësi p.sh ia kërkojnë një milion vlerën, tash komuna i regjistron këto, tani për këtë lëndë mundet me pas ekspertizë të shkallës së parë financiare dhe këtu është bërë ndërlikimi i tyre edhe personat përgjegjës në drejtorinë e zyrës ligjore nuk e kanë pasqyruar mirë edhe e kanë nënvlerësuar për një milion.

Fatos Dibra: - tha se ky raport kur ka ardh në zyrën ligjore edhe kemi shiku ku është gabimi, kemi ne lëndë të 2003, 2005, që dikush ka kërkuar dhe që na kanë kall në luftë dhe që komuna nuk është kompetencë për me i kthi para ose diçka, as të sigurisë publik, as asgjë. Dhe për shkak të mosfunksionimit të mirë të gjykatave tek ne raportet duhet me i paraqit krejt dikush që ka paguar në 2005 e qet njëherë në javë 2024 gjykata nuk ka vendos asgjë dhe ndoshta nuk është mbajt asnjë seancë paraqitet si një detyrim kontingjent se për me mundur me paraparë ti buxhetin. Buxhetin për një vit nuk mundesh me paraparë në rastet e partive të komunës 2010, 2011, 2012, 2015, 2017 sepse ajo punë ndoshta nuk ka asgjë të shkallës së parë as të dytës do me thënë edhe është proces i gjatë, çka ka ndodh kanë paraqit detyrime kontingjente të viteve të fundit dhe jo të krejt viteve dhe këta kanë qit që domethënë është bërë gabim ne nuk e kemi problem, por që ndikon ai në planifikim të buxhetit, e që mundesh ti me planifiku një buxhet më mirë sepse e paraqesim një lëndë në 2005 ku dikush i ka pyet pesë milionë euro, nuk besoj që ka ndikim mundem me i qit krejt prapë.

Osman Billaca: - tha se ky është problem i yni i brendshëm, ky problem i mosparaqitjes së saktë dhe prezantimit të saktë pra të hyrave financiare, detyrimet kontingjentete ky është intervenim vetëm i yni i asnjë akteri të jashtëm nuk është se ne vitin e kaluar i kemi pas dy vlerësime tash janë.....që i bie nëntë milionë e diçka, ne i kemi padi që na kanë ardhë dhe ne nuk i kemi pasqyruar vizat e kështu është vitin e kaluar kanë qenë të mbivlerësuar e tash i kemi nënvlerësuar. Problem është që nuk janë kalkuluar mirë edhe i kanë marrë prej ekspertizës financiare mandej prej themelores shkon ne apel, apeli bënë prapë ekspertizë mandej vjen vendimi i formës së prerë, probleme që duhet me i zgjedh këta. Çështja tjetër është pagesa e investimeve kapitale problem i integriteteve problem që e kemi zgjidh këta, e ka regjistruar një rrugë, këtë rekomandim e ka implementu Valbona, është zgjidhe është implementuar deri me (16) gjashtëmbëdhjetë shtator kur e kemi bërë verifikimin e rekomandimeve ku nuk ka pas asnjë gabim, domethënë kanë qenë krejt të regjistruar edhe A 3 (treshi) dy fatura të papaguara 2023, dy mijë e njëzet gjashtë mijë që nuk janë pasqyruar deri më tash nuk ka pas as për këto kur është bërë edhe për obligime financiare nuk ka pas asnjë faturë të papaguar, ka qenë pak më e lehtë, por është që e ka pasqyruar auditori vetëm B (1) njëshi është çështjen më e ndieshme dhe është çështja e cila është gjatë ekzekutimit të buxhetit janë realizuar pagesat me vlerë katër

milionë e treqind e pesëdhjetë milionë euro prej kategorive joadekuate, shumë keq që ndodh këto në i bëjmë me vetëdije për arsye se të dhënat e shpenzimeve është tavani buxhetor i caktuar për tri vitet e fundit edhe nuk na lejohet më tepër në lidhje me këto tash kur bëhet një investim kapital ai menjëherë në rastet e fundit kërkon menjëherë shërbimin me u merr me to ose me ndërtimin e një shkollë, i rrugëve, arkitekti i qytetit është ai i cili projektet i realizon.

Valbona Makolli: - tha se kemi disa prej të gjeturave që janë përsërit janë edhe punëve të Kuvendit unë po flas për drejtorinë time dhe do e prezantoj edhe në Kuvend. Jemi në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Tatimit në Pronë, ku si të gjetur e kemi problemin e identifikimit të ID-ve të qytetarëve, ku ka qytetarë që nuk janë, ose kanë vdekur ose kanë ndryshuar komplet adresën, e kemi problem jashtëzakonisht të madh një nga të gjeturat është edhe mbledhja e detyrueshme që është bërë ligji por nuk ka udhëzim administrativë qysh shkon edhe Ligji i Tatimit ATK-së, por sistemi që është në Ministri të Financave duhet me u koordinu se ATK-ja ka njerëz që punojnë në banka, në momentin që kalon pagesa në momentin që kalon pagesa mundet me ia marr obligimet, kurse ne si komunë nuk mundemi nuk e kemi, ata e kanë pa pasi ka dal lista, tash janë duke e bërë udhëzimin administrativ, mirëpo është e gjetur, disa prej punëve janë të papërfunduara dhe disa të përsëritura.

Osman Billaca: - po ashtu dha sqarime për të gjeturat e kontratave publike në kornizë, etj.

Gëzim Sveçla: - tha se tek subvencionet pa thirrje kur e kemi pyet Fatosin ke thënë që bën, auditori po thotë që nuk bën, Ministria e Financave thotë se nuk bën.

Fatosi Dibra: - tha se Ministria e ka kthyer në kohë dhe unë nuk mundet me bë këtë gjykim për një shkesë të ministrisë. Sa i përket asaj që po them unë nëse ne folim për rregullore ato nuk vijnë në kuvend hiç, dhe nëse thua ti si ministri, vendimi nuk ju ka përmbajt rregullores ti për mendimin temë e ke fituar me suksese me ju përmbajt asaj rregullores, s'ka Kuvendi në atë rregullore asgjë hiç, përpos me miratuar buxhetin edhe ato që i kanë në buxhet dhe këta me procedurë administrative me bë thirrje, me aplikua me i shpallë konkurset.

Bahri Gashi: - pyeti se te raportet e auditimit te Komunitat e Kosovës, ku jemi si qytet, si Prishtinë.

Valbona Makolli: - tha se prej tridhjetë Komunave që janë audituar mbi gjysma kemi dal negativë, së bashku me MAPL- në, Zyrën kombëtare të auditimit edhe komunat të cilat na kanë thirr krejt, qytet e mëdha kryesisht kanë dal keq.

Bahri Gashi: - tha Ligji i Prokurimit është një nga ata që bënë problem vazhdimisht, Ligji i Prokurimit çdo Komunë, çdo Ministrie, çdo Institucioni e ka që punon Ligji i Prokurimit vazhdimisht ju bënë problem, ku ka ardh me një pikë se çmimi më i lirë po bënë problem në këto raste dhe po ka shumë probleme në gjithçka, kështu që nuk qenka vetëm i yni.

Leutrim Retkoceri: - tha se në seancë pres që kryetari të dal të prezantojë për zotimet e të gjeturave, kjo pikë duhet me u shty ose nuk duhet me qenë. Kishte qenë mirë me definuar. Drejtoreshë, i kemi këto raste që edhe raporti i auditorit i ka,ka domethënë pagesa nga kode jo adekuate edhe ka pagesa prej një kodit në kodin tjetër që është një shumë, shumë e lartë. Pse ndodhë kjo.

Valbona Makolli: - tha se këtë në bashkëpunim edhe me Ministrinë e Financave edhe me auditorin..... kanë ardhë Ministria e Financave, me e ditë që është në klasifikim.....edhe unë kam menduar që është mirë, ai po thotë... për derisa Ministria e Financave e ka atë kod që krejt komunitat e kemi të njëjtin gjë. Nuk është praktikë e mirë ose me thënë që është e mirë, se po ndryshon. Nëse ... sinjalizimin vertikal dhe horizontal është problem se Ministria e Financave... se kjo ka qenë vlera 1,000,000 ..

Leutrim Retkoceri: - tha se kjo puna me i marr paratë, me bë pagesa prej një kodit ose me bë gabime, këtu ka përgjegjësi tjera. Për këtë është me rëndësi drejtoreshë, unë po të përmirësoj, po të pyes për procedurën nga ka ardh.

Valbona Makolli: - edhe tjetra po thotë nëse ti nuk e bënë kur ke mjete financiare, e nuk e ke bërë pagesën.....ama 1,500,000 është që ia kemi ndarë Ndërmarrjes së Gjellbër.. në ditët tjera i kemi përmirësuar.

Pika e gjashtë

Propozim-vendimi për ndërrimin e destinimit të bllokut 1-1 Q-2, 1-2 sipas destinimit të PZHU-së në Prishtinë.

Nora Kelmendi: - a mundet dikush me më tregu çka është dallimi mes 6 dhe 7. A e dini pse, se te 6 e keni bërë vendimin edhe arsyetimin e keni të riparcelimit, m' i keni përzier gjërat, nuk po kuptoj. Pse i keni bërë dy pika, kur kjo ka qenë vetëm një pikë. Plus e keni sjellë njëfarë, shefat e grupeve që ua kanë dërguar këta disa banorë dhe këta janë për këtë bllokun 1-1 Q-2, 1-2, a po më tregoni pse i keni bërë dy vendime, kur kjo ka qenë një.

Fatos Dibra: - është ndarë për shkak të problemit që është heq prej rendit të ditës, gjithmonë për shkak të riparcelimit.

Nora Kelmendi: - tha pse i keni ndarë, kur është gjë e njëjtë. Në rregull, çka është pika 6-të çka është pika e 7-të, kanë qenë me një vend.

Fatos Dibra: - Problemi ka qenë jo i ri parcelimit, te ai problemi ka qenë që komuna ka thënë ndoshta ka .. ambulanca dhe shkolla. Ambulanca po ndërtohet diku tjetër, edhe kemi pas mospërputhje në mes të PZHU-së..... edhe Prishtina e re nuk e ka pas të përcaktuar lokacionin saktë, e në planin rregullues domethënë nuk ka qenë aty, ka qenë domethënë ballafaqimi nëpër gjykata, që ata duhet me marrë PZHU-ja apo duhet plani. Kur e ka sjellë Kuvendi, e ka sjellë me petition për me rregulluar këtë çështje, a pati kthyer ministria në kohë dhe është kthyer në kuvend është anuluar, dhe ky ka vazhduar me gjykata. Ky destinimi ka të bëjë me ata që ka pas probleme në gjykatë, ndërsa ky riparcelimi që kanë dashtë me e fut me një me e bërë, ky është i vetmi plan rregullues me sa e di unë. Plani rregullues është i vetmi plan kur është bërë, vetëm domethënë planifikimi i koeficientëve, ka bërë edhe parcelim dhe në atë gjendjen ekzistuese ka hy përmes shtëpive. Me heq parcelimin komplet, komplet planin jo vetëm të këtij. Ky është për këtë me e ndërruar destinimin.

Nora Kelmendi: - tha jo, këtë nuk po them me e heq, veç për ndryshimin e riparcelimit po thotë, nuk po thotë me heq riparcelimin edhe me mbet plani qysh ka qenë, por po thotë me i ndryshuar këto parcelat qysh i keni ndarë, qysh është parcializuar.

Nora Kelmendi: - pyeti pse Komuna e Prishtinës ose urbanizmi, Drejtoria e Urbanizmit, sipas arsyetimit gjykata i ka thënë Drejtorisë së Urbanizmit me i kryer këto punë. Pse po i sillni në kuvend, a po frikësohen me i kryer, nuk ka nevojë me ardhur kjo në kuvend, se ne si asamblistë nuk kemi nevojë vendimet e gjykatës me i shqyrtuar. Nëse është vendimi i formës së re, gjykatës së apelit, ta kryejnë urbanizmi.

Fatos Dibra: - ky i pari që i kam ndarë .. besoj që ka të bëjë me njëfarë destinimi e kam ambulancën unë me plan rregullues me PZHU, nuk e ke ambulancën dhe ty si komunë ke filluar me ndërtuar diku tjetër ambulancën në atë lagje. Ti je duke i mbajtur peng qytetarët që sa kohë, me vite të tëra dhe në fund po thua që këtu nuk ta jap lejen se e kam ambulancën, e po shkon ambulancën po e ndërton më andej.

Nora Kelmendi: - Fatos nëse e ndërron destinimin me pikën 6, nëse e ndërron destinimin e këtyre blloqeve a e shliroi pikën 7, se i kemi pas me një vend, tani na i ndave.

Fatos Dibra: po, për atë se pika 7 komplet dhe për shkak të kësaj nuk ka kaluar as kjo tjetra. Këtu një hartë me vija të trasha, realisht...

Nora Kelmendi: - Fatos e ke pa vendimin e ke pa arsyetimin. Pse Komuna e Prishtinës ose urbanizmi, Drejtoria e Urbanizmit, sipas arsyetimit gjykata i ka thënë Drejtorisë së Urbanizmit me i kryer këto punë. Pse po i bini në kuvend, a po frikësohen me i kryer, nuk ka nevojë me ardhur kjo në kuvend, se ne si asamblistë nuk kemi nevojë vendimet e gjykatës me i shqyrtuar. Nëse është vendimi i formës së re, Gjykatës së apelit, ta kryejnë urbanizmi.

Fatos Dibra: - tha se ky është rasti edhe pse këtu për shkak një procedurës ligjore ka thënë që ato vendimet, aktgjykimin e ka lëshuar.. këtu është rasti kur ka pas aktakuzë domethënë Ardiani, Liburni, diku 5 zyrtarë të tjerë për moslëshim të lejes dhe kanë dalë të pafajshëm që nuk e kanë lëshuar lejen. Tani një zyrtar pa e ndërruar planin, unë nuk besoj që mundet me i lëshuar leje. Një zyrtar që është shpall dhe është dënuar i pafajshëm në atë kohë, por janë procedura të ndara, këto procedura administrative janë të ndara. Ky është rasti ku ky ka filluar me e bë projekt para ardhjes në Komunë të Prishtinës. Është miratuar plani .. po mendoj në fund ky Prishtina e re edhe i ka ndodh befasia, ky ka menduar që ka me pas me ndërtuar për të gjithë ata qytetarë. Prej asaj kohe domethënë mundet me i pas 10 vite apo 11, që ky njeri sillet gjykatave, sillet komunës me shumë qytetarë të tjerë, kishte pas edhe projekt të bërë. Tani ti e ke, hajde arsyetimi deri para 2-3 vite kur ti ambulancën ke thënë jo se këtu e kam unë, sepse ke thënë që PZHU-ja nuk e përcakton saktë ku parcelën, por thotë këtë zonë, se PZHU-ja njollën e ka diku tjetër realisht. Plani rregullues e ka këtu, tani vetëm atë njollën, që kemi thënë ne nuk e ka mirë PZHU-ja se po më del këtu, është duke u ndërtuar ambulanca me një lokacion tjetër, por në këtë rast ka pas me një vendim të kuvendit komunal më herët, nuk ka kaluar me njëfarë peticioni. Domethënë është rast kështu, historinë e ka 12-13 vjeçare.

Nora Kelmendi: - nëse e lexoni arsyetimin. Arsyetimi nuk thotë që duhet me ardhur në kuvend. Arsyetimi i zyrës ligjore e rekomandon Komunën e Prishtinës, Drejtorinë e Urbanizmit, të zbatojë menjëherë vendimin e Gjykatës së apelit. Nuk i rekomandon asamblistëve. Pse po doni me na e futë neve këtë.

Jeta Rafuna: - pyeti çka nëse kjo punë neglizhohet, ne si Kuvend komunal nuk marrim vendim për këtë punë.

Gëzim Sveçla: - tha që vendimi i gjykatës së apelit nuk është i diskutueshëm. Këtë ne e kemi thënë prej ditës së parë. Ideja është shumë e qartë, nëse kuvendi voton kundër, qysh? Ne po dalim po i diskutojmë, vendimet e gjyqësorit prej formës së prerë edhe votojmë kundër, që u krye.

Kryesuesi: - Atëherë vazhdojmë, pikën 6 dhe 7 a jeni për me e dërgua më tutje. Kush është për me e heq?. **6 janë për, 2 kundër dhe unë po abstenoj.**

Pika e gjashtë **Propozim-vendimi për ndërrimin e destinimit të bl.I-1, Q-2, I-2, sipas destinimit të PZHU-së në Prishtinë, dhe**

Pika e shtatë **Propozim-vendimi për ndryshimin e riparcelimit sipas gjendjes aktuale kadastrale (te banimi individual), të Planit rregullues “Prishtina e re – Zona perëndim” në Prishtinë, largohen nga rendi i ditës.**

Pika e tetë

Informatë mbi punën e Njësisë së auditimit të brendshëm për vitin 2023.

Osman Bilaca: - tha se planin për vitin 2023, e kemi miratuar bashkërisht me komitetin e auditimit, me kryetarin e komunës edhe unë. Për vitin 2023 i kemi paraparë 12 raporte të auditimit, 12 auditime me i bë edhe të 12-tat i kemi realizuar. Drejtorinë e Prokurimit, Drejtorinë e Financave, të Urbanizmit, të Shërbimeve Publike, të Administratës, Sektorin e burimeve njerëzore, menaxhimin e sistemit të pagave, Drejtorinë e Kulturës, Drejtorinë e Shëndetësisë, Drejtorinë e Arsimit dy herë e kemi audituar në fusha të ndryshme, Drejtorinë e Kulturës po ashtu dy herë me dy fusha të ndryshme, Drejtorinë e Sportit. 12-të raporte janë përfunduar me afat kohor. Për të 12-tat drejtori kanë bërë plane të veprimit dhe i kanë implementuar disa prej rekomandimeve të cilat ne i kemi dhënë. Për këto 12-të raporte ne i kemi dhënë 56 rekomandime, ku prej 56 rekomandimeve janë implementuar 34, 10 kanë qenë në proces dhe 11 të tjera nuk kanë filluar fare për implementim. Drejtoria e Financave tek një raport që i kemi dhënë 7 rekomandime, 5 i ka implementuar. Drejtoria e Arsimit për shkollat fillore dhe të mesme SHMU-të dhe SHML-të që e kemi bërë, prej 3 rekomandimeve, i ka implementuar 3. Drejtoria e Sportit prej 7 rekomandimeve, 5 i ka implementuar. Urbanizmi i ka implementuar, 5 i kemi dhënë dhe vetëm 2 i ka implementuar, por një rekomandim e ka implementuar shumë të madh i cili na ka ndihmuar shumë edhe në realizimin e të hyrave edhe me rritjen e performancës të të hyrave. Po ashtu në problemin e borxheve të cilat i kemi prej llogarive të arkëtueshme. Drejtoria e Shëndetësisë, 3 rekomandime i janë dhënë, 2 i kanë implementuar, ndërsa 1 e kanë në proces për tektim të parave, iu ka dështuar tenderi disa herë. Dodona, në Drejtorinë e Kulturës, 4 rekomandime, 2 i ka implementuar. Auditimi i performancës i cili iu ka bërë drejtorisë apo Sektorit të prokurimit, këtu është bërë një auditim, se ne kemi filluar tani përveç auditimeve pajtueshmërisë dhe të rregullsisë, këtu kemi filluar edhe auditime të performancës prej vitit 2023, ndërsa këtë vit i kemi bërë dy auditime të performancës në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe të Bujqësisë, dhe tashmë kemi nivel goxha të mirë njësinë e auditimit të brendshëm që po iu ndihmojmë edhe komunave tjera. Sa i përket njësisë së auditimit të brendshëm dhe sidomos auditimeve të performancës, te Drejtoria e Shërbimeve Publike, janë dhënë 5 rekomandime, 3 janë implementuar, te Drejtoria e Kulturës,

3 rekomandime janë dhënë për shpenzime kapitale, është implementuar vetëm 1. Drejtoria e Administratës, 4 rekomandime, 2 janë implementuar. Burimet njerëzore prej 5 rekomandimeve, 2 janë implementuar edhe te Drejtoria e Arsimit, 3 rekomandime, vetëm 2 janë implementuar. Ka edhe rekomandime të cilat janë dhënë dhe nuk janë implementuar fare, këto janë disa që kanë me u bë këtë vit, e sidomos është te Drejtoria e Arsimit është te këto ekskursionet që do të implementohen se janë duke i organizuar sivjet, edhe pse kemi dhënë rekomandim që me trajtuar edhe me sqaruar kryetari bashkë me nënkryetaren edhe Drejtorinë e Arsimit. Këtu ende nuk kemi marrë një vendim të formës së prerë që janë marrë organizuesit të ekskursionit a jo. Ne nuk kemi qenë për me i ndarë ekskursionet, por me u zbatuar komplet edhe rregullorja e brendshme e cila është për organizimin e ekskursionit, si dhe udhëzimi administrativ i cili e paraqet për të gjitha këto, sepse kjo ka pas... edhe për neve edhe personalisht për mua që po i ndal ekskursionet, por i kemi ndal, ne kemi dhënë rekomandim që me qenë agjenda mirë, plani mirë, gjithçka me u organizuar mirë, konform, si e parashihet i gjithë këshilli drejtues, drejtori i shkollës dhe Drejtoria e Arsimit duhet të marr masa strikte në mënyrë që mos të kemi probleme siç kemi pas në ekskursionet edhe atje në hotel apo kudo që kemi qenë. Normalisht që e kemi përfunduar punën 100% me të gjithë. Implementimi është në nivel të mirë, ka përmirësim të implementimit edhe të rekomandimeve të auditorëve të brendshëm edhe jashtëm, por dëshirojmë që edhe ato rekomandime, për shembull 11 që kanë qenë në proces me u përfunduar, por tani të jemi shumë të sqaruar në ndryshimin e drejtorëve edhe ndryshimet politike ndikojnë edhe te implementimi i rekomandimit

Gëzim Sveçla: - pyeti për drejtoritë e formuara nga kryetari të cilat janë të jashtëligjshme edhe zyrtarisht kështu, për të cilat është nis konflikt administrativ, a auditohen.

Osman Billaca: - Jo, ato unë në momentin e marrjes së vendimit prej kur kanë formuar drejtorinë e qysh janë ato, ne funksionojmë në bazë të zyrtarizmit apo zyrtarisht. Pa qenë e kodifikume, pa qenë në buxhet, unë nuk mundem me audituar.

Pika e nëntë

Informatë e punës 1 janar – 31 gusht 2024, i NPL “Pallati i Rinisë”

Dhurata Jahaj: - tha se kemi raportuar më herët, në vitin e kaluar 1 janar deri 31 gusht 2024. Është një gëp këtu, se ka probleme me këtë folderin që e kanë dërguar, na duhet me ua përmirësuar, me i bë disa përmirësime, kështu që kërkoj falje në emër të tyre. Ajo pse ka ndodh ndoshta veç e keni kuptuar se pasi ishim te auditimi, mbas raportit të auditimit ka pas diskrepanca shumë të mëdha. Edhe një pjesë të 2023-tës sidomos 2022-tës na kanë njoftuar bordi neve dhe ne i kemi rekomanduar që me u marrë organet kompetente. Në momentin që ne njoftohemi për parregullsi, janë organet kompetente gjë që edhe e kemi bërë, besoj që kemi vepruar mirë. ZKFF-ja nuk ka pranuar me i nënshkruar pasqyrat financiare, bordi pastaj na e ka deleguar neve punën, kështu që me rregullore, me ligj neve nuk na takon ajo, e as nuk e kemi marrë përsipër. Unë e kam rekomanduar decitivisht që me u marrë organet kompetente me këtë çështje.

Leutrim Retkoceri: - pyeti se, ZKFF-ja ua ka dërguar juve me nënshkruar.

Dhurata Jahaj: - tha jo, ZKFF-ja nuk ka pranuar me i nënshkruar ajo vetë raportet me ato problematikat që i ka pas. Pastaj kanë shkuar te bordi, bordi ka marrë vendim që me na treguar neve situatën si është edhe ne e kemi rekomanduar bordin që të shkojë tutje.

Gëzim Sveçla: - pyeti se për periudhën që po flasim, shtator 2023, shtator, tetor, nëntor ne nuk kemi raport.

Dhurata Jahaj: - edhe njëherë po kërkoj falje në emër të tyre, nuk e kanë bërë raportin siç duhet, nuk e kanë përpiluar. Kështu që besoj që sot ose nesër, se kishim edhe këto çështjet, këto ditë nuk kemi mundur me u marrë, por shumë shpejt ju dërgojmë. Me mirëkuptimin e juaj, sot ose nesër ju dërgojmë.

Gëzim Sveçla: - tha se dje ka dalë një artikull në media për negociatat e Kryetarit Rama me kompanitë private, në lidhje me dhënien në shfrytëzim të Pallatit të Rinisë. Pjesë e tekstit shkruan që bordi është i njoftuar për këto bisedime. Ai pyeti se a ka bordi informata për këtë punë edhe ju si aksionarë.

Dhurata Jahaj: - tha po flas për vete, nuk po flas për dy koleget e mia sepse njëra ka qenë në takim, ka qenë në takim, nuk e di arsyen e takimit shumë të qartë, por janë diskutuar çështjet e tilla. Nuk mundem me dhënë informacion më shumë për takimin, se unë nuk kam qenë pjesë e takimit. Nuk na kanë dhënë ndonjë informacion tutje, kështu që për këtë pyetje ndoshta më mirë kishte me qenë me u përgjigj kryetari.

Gëzim Sveçla: - tha po patjetër, por ti je përfaqësuese e jona, se je e zgjedhur prej Kuvendit. Si aksionare se kjo është edhe me procesverbal, po të obligojmë me e njoftuar edhe bordin, që Kryetari Rama nuk menaxhon me pronat e komunës. Ai i ka 33 % aty, e ka një përfaqësues, 66-67 % i ka Kuvendi. Edhe për procedurat tjera këtu desha me u lidhë pastaj me zyrtarin ligjor se janë shumë të qarta edhe procedurat për PPP-në edhe për dhënien në shfrytëzim të pronës publike, këto negociatat e kryetarit a janë ligjore, për pronë publike po flasim.

Fatos Dibra: - tha negociatat, ato duhet me qenë zyrtare. Negociata nëse flitet për dhënin në shfrytëzim dhe negociat, janë dokumente që bëhen aty. Është çështje PPP-ja që e përmende është diçka tjetër. Ndërmarrje publike për me e dhënë në shfrytëzim një pronë për kuvend, pastaj është problematike a duhet ndërmarrja me u lëshuar apo çka duhet me u bë, apo ndërmarrja mundet me e bë me lëshuar me qira një pjesë.

Leutrim Retkoceri: - a ka drejtë ndërmarrja, në këtë rast kryetari me 33% të aksioneve. Është pyetja për kryetarin, me negociu me dhënë pronën e ndërmarrjes publike në shfrytëzim për 20 ditë. Kryetari me aksionarët. Pastaj pyeti a e përfaqësojnë aksionarët vullnetin e Kuvendit në këtë rast.

Gëzim Sveçla: - tha se dje ka ndodhur, është seanca e parë e NPB-së, ku janë të akuzuar, pjesë e akuzës janë edhe aksionarët. Tre aksionarë edhe të Kuvendit edhe të kryetarit. Tre aksionarët, anëtarët e bordit kryeshefit, të gjithë. Dje ka qenë seanca e parë, prandaj edhe si aksionarë, por edhe bord duhet me qenë të përgjegjshëm për çdo veprim që ndodh. Është krejt joligjore çka ka bë Përparim Rama, se bordi udhëheq me ndërmarrjen, nuk udhëheq kryetari askund hiç. Veç me pa kështu pa asnjë akuzë dhe pa tendencë. Bordi e udhëheqë tani, jo aksionarët, ajo është pjesa menaxheriale, këta janë kontrollues të bordit. Por megjithatë, një vendim i tillë duhet kaluar nëpër bord.

Dhurata Jahaj: - pyeti nëpër bord, apo përmes aksionarëve.

Gëzim Sveçla: - tha jo, për me e dhënë një pronë një ndërmarrjeje bordi vendos, nuk vendos kryeshefi krye në veti. Po ju jeni ata të cilët i mbikëqyrni këto veprime, se pastaj përgjegjësia penale iu rrok edhe juve.

Bahri Gashi: - pyeti a mundeni me ditë a jeni në nivel me tregun, duke pyetur pastaj se çka do të bëni për me arrit nivelin e tregut. Pavarësisht asaj niveli i tregut është normal sepse ti po jep një aset shumë të gatshëm edhe ai që po e merr po fiton prej asaj. Në fund pyeti se a keni menduar ju si komision i aksionarëve me i rekomanduar bordit për ta rishikuar këtë punë.

Dhurata Jahaj: - u përgjigj se nuk janë në nivel me tregun, duke shtuar se e kemi rekomanduar bordin edhe jemi marrë me një çështje, por aty dihet në “Pallatin e Rinisë” si janë kushtet.

Bahri Gashi: - Pazari i Prishtinës, këtu që e kemi prapa shpinës, kushtet janë mizerje, a e di sa shtrenjtë e kanë qiranë, me siguri më shtrenjtë se në “Pallat të Rinisë”.

Dhurata Jahaj: - tani nuk mundesh, me ua rritë qiranë kur atyre iu pikë uji dhe vendosin kova dhe ti nuk mundesh me ua bë qiranë sa dikujt tjetër.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30

**Procesmbajtësja
Vlora Krasniqi**

